



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

VENDIM

I

KËSHILLIT DREJTUES

NR. 3, DATË 25.04.2017

Sot, më datë 25.04.2017, në orën 15:00, në selinë e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), u mbledh Këshilli Drejtues i ADISA, ku janë të pranishëm:

- Z. Lorenc Bako (Kryetar);
- Z. Artur Pilkati (Anëtar);
- Z. Enea Hoti (Anëtar); dhe
- Z. Ervin Sherifaj (Anëtar).

Nuk janë të pranishëm në mbledhje tre anëtarë të Këshillit Drejtues:

- Znj. Alba Çaroshi;
- Z. Bledar Doracaj; dhe
- Znj. Juliana Hoxha.

Në mbledhje morën pjesë gjithashtu Drejtori Ekzekutiv i ADISA, Znj. Anisa Gjika, Drejtori i Administrimit të Brendshëm Znj. Edlira Cimbi dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Monitorimit të Standardeve Z. Erkand Kola.

Këshilli Drejtues u mbledh dhe diskutoi për të vendosur lidhur me pikat e rendit të ditës, me të cilat ishin njohur nëpërmjet njoftimit më datë 20.04.2017.

Pasi diskutoi në lidhje me to, bazuar në Ligjin Nr. 13, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues, në unanimitet,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren e brendshme për funksionimin e zyrave pritëse, bashkëngjitur këtij Vendimi;
2. Të miratojë Rregulloren “Për menaxhimin e aktiveve në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, bashkëngjitur këtij Vendimi;

Adresa: Bulevardi “Zhan d ‘Ark”, ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al



3. Të miratojë Rregulloren e brendshme “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e detyrave funksionale në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, bashkëngjitur këtij Vendimi;
4. Të miratojë Rregulloren e brendshme “Për procedurat e analizimit, vlerësimit dhe trajtimit të riskut në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, bashkëngjitur këtij Vendimi;
5. Të miratojë Rregulloren e brendshme “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, bashkëngjitur këtij Vendimi.

Ky Vendim hartohet në 2 (dy) kopje.

Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i ADISA për ndjekjen e mëtejshme të procedurave në zbatim të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Lorena Bako

